

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Isa Kelmendi dhe Gëzim LLulluni, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.G., nga fshati ... Komuna e Suharekës, të cilin e përfaqëson B.L., avokat, kundër të paditurës Komuna e Suharekës-Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson avokati publik S.G., me bazë kompensimin e pagave përcjellëse në pension, duke vendosur sipas ankesave të t' autorizuarit të paditësit, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, C.nr.124/13, i datës 11.10.2013, dhe aktvendimit C.nr.124/13, i datës 14.04.2014 në seancën jo publike të mbajtur me datë 28.09.2015, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit S.G., nga(adresa) , PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, C.nr.124/13, i datës 14.04.2014.

II. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të paditësit S.G., nga fshati ... dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Dragash, C.nr.124/13, i datës 11.10.2013.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.124/13, i datës 11.10.2013 në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit S.G., nga ..., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Suharekës-Drejtoria e Arsimit, që ti paguaj shumën prej 935.18 Euro, në emër të pagesës me rastin e shkuarjes në pension, ndërsa në pikën II të dispozitivit është vendosur që shpenzimet ti barët vet paditësi.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi përmes të autorizuarit të tij në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Ankesa e paditësit i është dorëzuar të paditurës për përgjigje në ankesë, por e njëjta nuk ka paraqit përgjigje në ankesë.

Pasi që pala paditëse ka paraqitur ankesë akundër aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë me datën 14.01.2014, i ka dërguar palës paditëse vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e datës 14.01.2014, të cilën i autorizuari i paditësit e ka pranuar me datën 17.01.2014.

Pas pranimit të vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore për ankesë i autorizuari i paditësit i drejtohet gjykatës me parashtresën e datës 21.01.2014, me kërkesë për lirim nga detyrimi i pagesës së taksës gjyqësore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas kërkesës së paditësit për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore për ankesë, me aktvendimin C.nr.124/13, të datës 27.01.2014 e refuzon si të pabazuar kërkesën e të autorizuarit të paditësit për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e veçantë C.nr.124/13, të datës 14.04.2014, ka vendosur të refuzoj kërkesën e të autorizuarit të paditësi për dërgimin e lëndës sipas ankesës në Gjykatën e Apelit pa paguar taksën gjyqësore për ankesë. Ndaj këtij aktvendimi me të cilin është refuzuar kërkesa e të autorizuarit të paditësit për dërgimin e lëndës në gjykatën e shkallës së dytë pa paguar taksën gjyqësore për ankesë, paditësi përmes të autorizuarit ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktvendimin C.nr.124/13, të datës 14.04.2014, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore.

Pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, aktvendimit C.nr.124/13, i datës 14.04.2014 dhe aktgjykimit të atakuar C.nr.124/13, i datës 11.10.2013 si dhe shkresave të lëndës, në pajtim me dispozitën e nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit ka vërtetuar së:

Ankesa është e bazuar ndaj aktvendimi të goditur C.nr.124/13, i datës 14.04.2014, ndërsa është e pathemelta ankesa e paraqitur ndaj aktgjykimit të goditur C.nr.124/13, i datës 11.10.2013.

Nga shkresat e lëndës rezulton së paditësi S.G., nga fshati ... Komuna e ..., e ka paditur Komunën e Suharekës-Drejtorinë e Arsimit, për pagesën e pagave me rastin e shkuarjes në pension.

Gjykata e shkallës së dytë ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi pasi që ka gjetur së aktvendimi i atakuar C.nr.124/13, i datës 14.04.2014, është marrë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 1, lidhur me nenin 188.1 të LPK-së.

Nga shkresat e lëndës rezulton së pas vendosjes meritore të çështjes kontestuese në mes të paditësit dhe të paditurës, pala paditëse e pa kënaqur më aktgjykimin e gjykatë së shkallës së parë C.nr.124/13, i datës 10.11.2013, paraqet ankesë e cila pranohet në gjykatë më datën 14.01.2014, ndërsa gjykata e shkallës së parë më datën 14.01.2014, i dërgon palës paditëse vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për ankesë, të cilën i autorizuari i paditësit e ka pranuar me datën 17.01.2014.

Pas pranimit të vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore për ankesë i autorizuari i paditësit i drejtohet gjykatës me parashtrësën e datës 21.01.2014, me kërkesë për lirim nga detyrimi i pagesës së taksës gjyqësore, ndërsa gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e datës 27.01.2014 e refuzon si të pabazuar kërkesën e të autorizuarit të paditësit për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore.

Pas marrjes së aktvendimit për refuzimin e kërkesës së paditësit për lirim nga taksa gjyqësore, gjykata e shkallës së parë e merr edhe një aktvendim të veçantë, C.nr.124/13, i datës 14.04.2014, me të cilin vendos të refuzoj kërkesën e të autorizuarit të paditësi për dërgimin e lëndës sipas ankesës në Gjykatën e Apelit pa paguar taksën gjyqësore për ankesë.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjen në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë sipas aktvendimit të atakuar C.nr.124/13, i datës 14.04.2014 dhe ka gjetur së pretendimet ankimore të palës paditëse për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore janë të bazuara.

Kjo gjykatë vlerëson së aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 1, lidhur me nenin 188 par 1, i LPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të cituar për arsye së dispozita e neni 188 par 1 e LPK-së, përcakton detyrimin e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të qartë si në vijim: “: pas pranimit të përgjigjes në ankesë, apo pas skadimit të afatit për përgjigje në ankesë, gjykata e shkallës së parë ankesën dhe përgjigjen në ankesë, nëse është paraqitur me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë në afat prej shtatë ditësh më së shumti”. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë më aktvendimin e atakuar ka bërë shkelje të kësaj dispozite të procedurës kontestimore, pasi që ajo gjykata në mënyrë të gabuara i ka zbatuar edhe depozitën e neni 253.5 të LPK-së, si dhe dispozita e Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimet e KGJK-së nr. 20/2012 të dt. 09. 03. 2012, si dhe vendimit nr. 37/2012 të dt. 23. 03. 2012 (Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore).

Me dispozita e neni 6 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, parashihet mbledhja e taksave dhe efekti i mos pagesës së taksës, ndërsa në mënyrë specifike me dispozitën e neni 6.4 të këtij udhëzimi parashihet së: “ nëse nuk paguhet me kohë taksa për dozimin e parashtrësës, nga pala kërkohet pagesa e taksës shtesë, siç është përcaktuar në nenin 10.25 të këtij udhëzimi”.

Në rastin konkret ankesa e paditësit është parashtrësë sepse në grupin e parashtrësave sipas dispozitës së neni 99 par 1 të LPK-së, parashtrësja janë edhe mjete e goditjes.

Me qenë së në rastin konkret bëhet fjalë për një parashtrësë për të cilën pala ankuese nuk e ka paguar taksën gjyqësore sipas vërejtjes së parë të gjykatës, atëherë gjykata e shkallës së parë është dashtë që në kuptim të dispozitës së neni 6.4 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, ti dërgoi palës ankuese edhe vërejtjen e dytë më të cilën kërkohet edhe pagesa e taksës shtesë .

Në qoftë së pala ankuese nuk do të kishte vepruar pastaj as pas vërejtjes së dytë për pagesën e taksës gjyqësore atëherë gjykata e shkallës së parë do të duhej të vepronte sipas dispozitës së neni 6.5 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, me të cilën parashihe së; “nëse nuk paguhet taksat deri në datën e caktuar, gjykata do ta njoftojë personin që është dashur t’ i paguajë taksat, se ka përcaktuar një datë përfundimtare deri kur duhet të paguhet të gjitha taksat e papaguara, duke përfshirë edhe taksat shtesë, sipas neneve 6.4 dhe 10.25. Nëse ato nuk paguhet deri në datën përfundimtare, gjykata do të hedh poshtë parashtrësën për të cilën nuk janë paguar taksat”.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë duke mos vepruar sipas procedurave që parashihet Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, ka vepruar në shkelje të dispozitës së neni 188 par 1 të LPK-së, duke marrë aktvendimin për mos dërgimin e lëndës në gjykatën e shkallës së dytë.

Më qenë së gjykata e shkallës së dytë e ka pranuar si të themelte ankesën e palës paditëse dhe e ka prishur aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë për mos dërgimin e lëndës së paditësit në gjykatën e shkallës së dytë, atëherë kjo gjykatë e ka marrë në shqyrtim dhe vlerësim edhe ankesën e paraqitur nga palës paditëse

përmes të autorizuarit të saj, e ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetura së ankesa e paraqitur kundër aktgjykimit të goditur C.nr.124/13, i datës 11.10.2013, është e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së parë, me qëllim të vlerësimit të plot dhe të drejtë të gjendjes faktike, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur me datën 11.10.2013, ka bërë administrimin e provave me leximin e kontratës së punës, e lidhur në mes të paditësit dhe Komunë së Prishtinës, nr.73/30, e datës 30.09.2012, kontratën e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, 05 nr.195/11, e datës 01.09.2011, sipas të cilës paditësi ishte punësuar si mësimdhënës në shkollën fillore e mesme e ultë “ Vaso Pashë Shkodrani” në fshatin ..., aktvendimin e të paditurës mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, 05 nr.194, i datës 11.02.2013 dhe aktvendimin e të paditurës 01 nr.16-1881, i datës 13.03.2013, me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit për realizimin e pagave sipas Kontratës Kolektive.

Pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të dispozitave të nenit 8 të LPK-së, gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar së paditës kishte qenë në marrëdhënie të punës në shkollën fillore “ Vaso Pashë Shkodrani” në fshatin ..., Komuna ..., deri në arritjen e moshës së pensionit përkatësisht deri në datën 11.02.2013. Pas marrjes së vendimit për pensionim paditësi ishte ankuar tek e paditura duke kërkuar edhe shpërblimin jubilar për shkuarjen në pension por e njëjta kërkesë i është refuzuar nga kryetari i komisionit për zgjedhjen e ankesave dhe parashtrësve tek e paditura. Këtë gjendje faktike gjykata e shkallës së parë e ka konstatuar nga provat e administruara por edhe nuk ka qenë kontestuese nga palët ndërgjyqësore.

Gjykata e shkallës së parë pasi që kishte vërtetuar gjendjen faktike si me lartë kishte vendosur të refuzoj kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar me arsyetim nuk është kontestuese se Kontrata Kolektive ka hyr në fuqi me datën 01.01.2005, ndërsa me dispozitën e nenit 6.4. të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë është parapa: “ marrëveshja kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje prej jo me shumë së tri vite”. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësi meqë i njëjti ishte pensionuar me datën 11.02.2013, ndërsa Kontrata Kolektive nuk ka qenë në fuqi, pasi që e njëjtë ka përfunduar në fillim të vitit 2008.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjen në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur së gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë parë dhe rrjedhimisht duke zbatuar në mënyrë të drejte të drejtën materiale.

Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë pasi që nga shkresat e lëndës rezulton së nuk ka qenë rrethanë kontestuese fakti së paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura deri në arritje e moshës së pensionit përkatësish deri me datën 11.02.2013. Kjo rrethanë është provuar edhe nga aktvendimi i të paditurës mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, 05 nr.194, i datës 11.02.2013

Kontrata Kolektive ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2005 me kohëzgjatje të zbatimit për tri vite përkatësisht deri me datën 01.01.2008, kur të njëjtës i ka skaduar afati i zbatimit përkatësisht i ka pushuar efekti juridik.

Në dispozitën e nenit 6.4 të Rregullores së UNMIK-ut, 2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, është përcaktuar saktësisht se Marrëveshja Kolektive mundë të lidhet për një periudhë të caktuar në kohëzgjatje prej jo më shumë se 3 vjet. Rregullorja e UNMIK-ut, 2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, ka qenë në fuqi në kohën e nënshkrimit të Kontratës Kolektive.

Me skadimin e aftit të Kontratës Kolektive e njëjta nuk mund të aplikohet për rastet tjera pas datës 01.01.2008, e as për rastin e paditësit meqë padia është paraqit në gjykatë me datën 28.03.2013, ndërsa paditësi është pensionuar me datën 11.02.2013, pasi që ka pushuar së zbatuari Kontrata e Përgjithshme Kolektive

Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat Gjykata e Apelit kujdesit sipas detyrës zyrtare, ndërsa shkeljet tjera të dispozitave të procedurës kontestimore nuk janë pretenduar më ankesë.

Sa i përket inkasimit të taksës për ankesë, pasi që shkresat e lëndës ti kthehen gjykatës së shkallës së parë e njëjta mund të veproi në kuptim të dispozitës së nenit 6.7 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit në pajtim me nenin 194, 209 par 1, pika (d) e lidhur me nenin 208 të LPK-së, ndërsa si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi u vendos në pajtim me nenin 194, 195 par 1, pika (d).

Gjykata e shkallës së dytë ka vendosur me aktgjykim në këtë çështje sipas ankesës pasi që ankesa kryesore ka qenë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë për të cilën gjykata e shkallës së dytë ka vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr. 1487/14, me datë 28.09.2015

Kryetari i kolegjit

Albert Zogaj, d.v